

**VENDIM**  
**Nr. 393, datë 9.6.2022**

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SHTETËRORE TË PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA DHE NGARKIMIN E KËSAJ AGJENCIE PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË VEÇANTA TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara (këtu e në vijim “ASHPP”), si person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit të Brendshëm (këtu e në vijim “ministri”), me seli në Tiranë.

2. ASHPP-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme. Buxheti i ASHPP-së është pjesë e buxhetit të Ministrisë së Brendshme.

3. Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara është organ qendror blerës, misioni i të cilit konsiston në mirëpërdorimin e fondeve publike, nëpërmjet kryerjes së procedurave të përqendruara të prokurimit të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla. ASHPP-ja zhvillon procedurat në fushën e prokurimit të mallrave e shërbimeve në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës.

4. Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara ka përgjegjësi të organizojë punën për kryerjen e procedurave të prokurimit për të nënshkruar marrëveshje kuadër dhe kryerjen e procedurave të prokurimit për të lidhur kontratë.

**KREU II**  
**ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË SHTETËRORE TË PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA**

1. Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara organizohet në nivel qendror dhe e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara drejtohet dhe përfaqësohet në marrëdhënie me të tretët nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e agjencisë dhe përgjigjet përpara ministrit.

3. Drejtori i përgjithshëm i ASHPP-së emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra nga ministri. Kriteret për emërimin drejtor i përgjithshëm janë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- ç) të ketë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vjet akademikë ose të barasvlershme me ta, sipas legjislacionit për arsimin e lartë.
- d) të ketë eksperiencë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën e prokurimeve publike;

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi.

4. Drejtori i përgjithshëm i ASHPP-së lirohet nga detyra në rastet e mëposhtme:

- a) jep dorëheqjen;
- b) mbush moshën e pensionit të pleqërisë;
- c) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën;
- ç) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit.

5. Drejtori i përgjithshëm i ASHPP-së shkarkohet nga detyra, në rastet e mëposhtme:

a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

- b) kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës;
- c) merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar.

6. Drejtori i përgjithshëm i ASHPP-së kryen detyrat, si më poshtë vijon:

a) drejton procesin e planifikimit buxhetor dhe të raportit vjetor të punës;

b) Raporton çdo 3 (tre) muaj dhe sa herë që kërkohet para ministrit për veprimtarinë e ASHPP-së;

c) drejton punën për përgatitjen e rregullores që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të ASHPP-së dhe/apo ndryshimet e saj dhe e dërgon atë për miratim të ministrit;

ç) drejton punën për përgatitjen e kërkesave të veçanta të pozicioneve të punës për rekrutimin e punonjësve të ASHPP-së;

d) emëron punonjësit e ASHPP-së në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës;

dh) nxjerr akte të brendshme për menaxhimin administrativ, financiar, të burimeve njerëzore dhe akte të tjera të brendshme, të detyrueshme për nëpunësit e ASHPP-së për realizimin e funksioneve të këtij institucioni;

e) krijon grupe pune, komisione apo struktura përgjegjëse për trajtimin e çështjeve të ndryshme në agjenci;

ë) zbaton legjislacionin në fuqi për prokurimin publik dhe blerjet e përqendruara, në cilësinë e titullarit të organit qendror të krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

f) çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga legjislacioni në fuqi dhe ministri.

7. Detyrat e Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit për lidhjen e një marrëveshjeje kuadër janë, si më poshtë vijon:

a) të bashkërendojë punën me autoritetet/entet kontraktore për mbledhjen e përpunimin e të dhënave, teknike e sasiore, të mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme dhe/ose të unifikuara;

b) të verifikojë përputhshmërinë e kërkesave të dërguara nga autoritetet/entet kontraktore, në raport me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike;

c) të përlogarisë fondin limit për sasitë e pritshme të mallrave dhe të shërbimeve që do të prokurohen, bazuar në kërkesat, afatin e marrëveshjes kuadër dhe fondin limit të dërguar nga autoritetet/entet kontraktore, duke vënë në dijeni autoritetin/entin kontraktor;

ç) të zhvillojë procedurat e prokurimit deri në nënshkrimin e marrëveshjes kuadër;

d) të shqyrtojë ankesat e operatorëve ekonomikë;

dh) të njoftojë autoritetet/entet kontraktore për mundësinë e lidhjes së një apo disa kontratave, në bazë të kërkesave të tyre, brenda afatit dhe limitit të fondit të përcaktuar në marrëveshjen kuadër.

8. Detyrat e Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit për lidhjen e një kontrate janë, si më poshtë vijon:

a) të bashkërendojë punën me autoritetet/entet kontraktore për mbledhjen e përpunimin e të dhënave, teknike e sasiore, të mallrave dhe shërbimeve, objekt prokurimi;

b) të verifikojë përputhshmërinë e kërkesave të dërguara nga autoritetet/entet kontraktore, në përputhje me legjislacionin dhe standardet në fuqi;

c) të përlogarisë fondin limit të kontratës për sasitë e mallrave dhe shërbimeve që do të prokurohen, përpara publikimit të njoftimit të kontratës, bazuar në kërkesat dhe fondet e autoriteteve/enteteve kontraktore, duke vënë në dijeni autoritetin/entin kontraktor;

ç) të zhvillojë procedurat e prokurimit deri në nënshkrimin e kontratës;

d) të shqyrtojë ankesat e operatorëve ekonomikë.

9. ASHPP-ja për nevojat e saj mund të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me institucione përkatëse brenda fushës së kompetencave të tyre për ofrimin e asistencës teknike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

10. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm dhe punonjësve të ASHPP-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

11. Rregullorja, që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të ASHPP-së, dhe/apo ndryshimet e saj miratohen nga ministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të ASHPP-së.

12. Shërbimet mbështetëse dhe ato të buxhetit e të financës për Agjencinë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara realizohen nga strukturat përgjegjëse për këto funksione në Ministrinë e Brendshme.

13. Struktura dhe organika e ASHPP-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

14. ASHPP-ja ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema e agjencisë përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Brendshme, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara”.

15. Vula e ASHPP-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vulat prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### KREU III

#### KRYERJA E PROCEDURAVE TË VEÇANTA TË PROKURIMIT PUBLIK

1. Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, si organ qendror blerës, për prokurimin e fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës, zhvillon procedurat në fushën e prokurimit të mallrave dhe shërbimeve, si më poshtë vijon:

a) blerje automjete;

b) blerje karburanti, me përjashtim të vajgurit Jet A1 dhe karburantit që prokurohet për përdorim nga fermerët;

c) blerje materialesh kancelarie;

ç) blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim;

d) blerje materialesh të ndryshme për pastrim;

dh) blerje uniformash dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre;

e) blerje këpucësh;

ë) blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike;

f) blerje tonerash;

g) shërbime në fushën e sigurimeve, si:

i. sigurim i automjeteve;

ii. sigurim i mjeteve lundruese;

iii. sigurim i mjeteve ajrore;

iv. sigurim jete dhe shëndeti;

v. sigurim i godinave publike;

gj) shërbim gatimi dhe shpërndarjeje ushqimi;

h) shërbim pastrimi;

- i) shërbim lavanderie;
- j) shërbim lysterje dhe mirëmbajtjeje të ndërtesave publike;
- k) riparim dhe mirëmbajtje automjetesh;
- l) botime, printime dhe materiale shtypshkrimi;
- ll) blerje materialesh të buta dhe veshmbathjesh;
- m) riparim e mirëmbajtje sistemesh të ngrohje-ftohjeve;
- n) blerje pajisjesh laboratorike, si dhe mjete didaktike, të lidhura me proceset e tyre të punës, me përjashtim të atyre mjekësore;
- nj) shërbime dezinfektimi, deratizimi dhe dezinfektimi;
- o) blerje artikujsh ushqimorë;
- p) blerje pajisjesh kondicionimi;
- q) shërbim gjelbërimi.

2. Bëjnë përjashtim nga parashikimet e pikës 1 të këtij kreu, institucionet e mëposhtme:

a) Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet e saj të varësisë, që realizojnë vetë procedurat e prokurimit me objekte, si:

- i. riparim dhe mirëmbajtje automjetesh;
- ii. blerje uniformash, veshmbathjesh dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre;
- iii. blerje këpucësh;
- iv. sigurim i mjeteve lundruese;
- v. sigurim i mjeteve ajrore;
- vi. sigurim jete dhe shëndeti;
- vii. sigurim jete detari dhe personeli fluturues.

b) shtypshkronjat e letrave me vlerë, që prokurohen sipas legjislacionit në fuqi;

c) shërbimi Informativ Shtetëror që realizon vetë procedurat e prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural realizon vetë procedurat e prokurimit për blerjen dhe shpërndarjen e karburantit, që prokurohet për përdorim nga fermerët në sektorin e bujqësisë.

d) drejtoria e përgjithshme e Burgjeve që realizon vetë procedurat e prokurimit, lidhur me:

- i. blerjen e automjeteve;
- ii. blerjen e pjesëve të këmbimit për automjete, për shërbimet profilaktike;
- iii. riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve; si dhe
- iv. blerjen e artikujve ushqimorë.

3. Autoritetet/entet kontraktore duhet t'i dërgojnë ASHPP-së, si organ qendror blerës, të dhënat teknike e sasiore dhe fondin përkatës për mallrat e shërbimet përkatëse, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin pasardhës.

4. ASHPP-ja krijon regjistrin e parashikimeve për procedurat e prokurimit që zhvillohen prej tyre menjëherë me mbledhjen e të dhënave, por, në çdo rast, jo më vonë se 20 (njëzet) ditë nga marrja e kërkesave për prokurim nga autoritetet/entet kontraktore.

5. Autoritetet/entet kontraktore kanë përgjegjësinë për të dërguar kërkesat teknike në përputhje me aktet ligjore në fuqi, duke garantuar gjithëpërfshirje të operatorëve ekonomikë, vendës apo të huaj, në procedurat e prokurimit.

6. ASHPP-ja unifikon specifikimet teknike për mallra dhe për shërbime që prokurohen në mënyrë të përqendruar, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendës apo të huaj, dhe harton katalogët e standardeve. Katalogët e standardeve miratohen me urdhër të ministrit të Brendshëm, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të ASHPP-së.

7. Në rastet kur ASHPP-ja, gjatë verifikimit të përputhshmërisë së kërkesave të dërguara nga autoritetet/entet kontraktore, me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, vlerëson se të dhënat teknike e sasiore të mallrave e shërbimeve të objekteve të prokurimit duhet të ndryshohen ose të saktësohen, u kërkon autoriteteve/enteve kontraktore, që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, të bëjnë rishikimin e tyre përpara publikimit të procedurës.

8. Në rastet kur ASHPP-ja konstaton se autoritetet/entet kontraktore kanë kërkesa, pasi është bërë publikimi i njoftimit të kontratës të procedurës së prokurimit, verifikon arsyet e vonës dhe shpall procedurën e re të prokurimit për këto kërkesa. ASHPP-ja duhet të informojë menjëherë Agjencinë e Prokurimit Publik (APP) në çdo rast kur konstaton mosrespektimin e afatit kohor.

9. ASHPP-ja, me kërkesë të një apo të disa autoriteteve/enteve kontraktore, zhvillon procedura prokurimi edhe për mallra apo shërbime, të cilat nuk janë listuar në pikën 1 të këtij kreu, në rastet kur autoriteti/enti kontraktor kërkues nuk ka kapacitete apo njohuri të mjaftueshme për realizimin e një procedure prokurimi.

10. Me kërkesë të ASHPP-së, çdo autoritet/ent kontraktor, sipas pikës 1 të këtij kreu, vendos në dispozicion specialistë të fushës, objekt prokurimi, për të asistuar agjencinë. Shpenzimet administrative mbulohen nga buxheti i aparatit të Ministrisë së Brendshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### KREU IV DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 81, datë 14.2.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara”, të ndryshuar, dhe nr. 82, datë 14.2.2018, “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë për disa mallra dhe shërbime”, të ndryshuar, shfuqizohen.

2. Të gjithë punonjësit, që janë në marrëdhënie pune në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, vazhdojnë marrëdhëniet e punës të rregulluara, sipas ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Autoritetet/entet kontraktore të përmendura në pikën 1, të kreut 3, të këtij vendimi, zhvillojnë vetë procedurën e prokurimit, me objekt “blerje tonerash”, për nevoja të vitit buxhetor 2022, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, Kryeministria, ministrinë e linjës, institucionet në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**